

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 12 MAJ 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Edi Rama vazhdon sjelljen e tij arrogante ndaj gazetarëve. Kryeministri i Shqipërisë i trajton gazetarët ashtu si i vjen atij për shtat dhe kur gjendet në vështirësi jo vetëm që e humbet profesionalizmin dhe eviton pyetjet që i drejtohen, por mundohet t'i vendosë gazetarët në lojë me pyetje intimiduese. Absolutisht, Kryeministri dhe qeveria nuk u përgjigjen asnjë pyetjeje të gazetarëve, që cenon sadopak aferat e tyre korruptuese dhe veprat e tyre kriminale, madje tallen dhe i dënojnë me riedukim këta të fundit, si rasti i fundit i gazetarit Klevi Muka. E njëjta gjë ndodh edhe me kërkesat e vazhdueshme për informacion nga ana e opozitës, të cilave qeveria u përgjigjet me heshtje totale dhe me përralla nga e kaluara. Megjithatë, kjo sjellje e përsëritur e Kryeministrit nuk tregon asgjë më shumë se arsyen e vërtetë pse media dhe liria e fjalës gjenden sot në këtë situatë. Jemi larg, shumë larg medias së lirë, ndodhemi në vendin e 104-t në rang global.

Të dashur qytetarë,

Në krye të AMA-s, Autoriteti i Medieve Audiovizive, Edi Rama ka vendosur ishzhëdhënësen e tij, zonjën Armela Krasniqi, duke shkelur hapur ligjin. Për ta thelluar më tepër këtë kapje të autoriteteve nga shteti kriminal, ndër 3 kompanitë që kontrollojnë tregun e reklamave, kompani private të cilat rekomandojnë se ku duhet të drejtohen reklamat, njëra prej tyre i përket vëllait të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Ligji "Për investime strategjike" është de facto ligji, që ka vendosur në rrezik të lartë dhe ka dëmtuar në mënyrë permanente shumë pasuri kombëtare, buxhetin e shtetit dhe ekonominë e familjeve shqiptare. Ky ligj, të nderuar kolegë, mbështet hapur oligarkët, që ushqejnë me vota qeverinë më të korruptuar të këtyre 30 vjetëve; ka zero transparencë, asnjë angazhim për të tërhequr investimet e huaja dhe asnjë mundësi e re punësimi. Këta investitorë strategjikë janë të gjithë individë pa asnjë kontribut real dhe pa asnjë ekspertizë konkrete.

Të gjithë këta individë i bashkon vetëm fakti se ata kanë lidhje të formave të ndryshme me pushtetin, disa prej tyre janë familjarë të ministrave, disa janë oligarkë që darkojnë me ministrat dhe disa të tjerë janë agjentë të nënshtruar të Rilindjes ose siç quhen ndryshe “patronazhistë”. Për të ardhur përsëri te patronazhistët, dëmet dhe shkelja e privatësisë së qytetarëve shqiptarë ka arritur deri në atë pikë, ku rrjeti tinëzar i makinerisë komuniste moderne të Rilindjes ka në dorë dhe përdor sipas qejfit të dhënat personale të çdo qytetari. Përveçse në shkelje të plotë të të drejtave themelore të njeriut, patronazhistët janë një mjet tipik i kohës së diktaturës komuniste për të mbjellë terror te qytetarët. Tri janë shtyllat, me të cilat Edi Rama mban në këmbë qeverinë e kimit të organizuar: nëpërmjet patronazhistëve, nëpërmjet kriminelëve e bandave dhe nëpërmjet investitorëve strategjikë anonimë.

Të dashur qytetarë,

Dje në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik u bëra thirrje deputetëve të maxhorancës që të bashkohen në kauzën tonë për mbrojtjen e Butrintit, si trashëgimi historike dhe kulturore, e mbrojtur nga UNESCO. Privatizimi dhe shfrytëzimi i vendeve me vlerë të tillë nuk duhet lejuar të ndodhë. Seanca dëgjimore që ne, deputetët e opozitës, kemi kërkuar me ekspertët e fushës do t’i japë zë një numri të madh problemesh të paadresuara nga qeveria dhe planet e saj okulte ndaj Butrintit.

I ftova dhe i ftoj edhe një herë deputetët e maxhorancës të mos marrin shembull nga paraardhësit tanë, të cilët krijuan një ligj të veçantë për shembjen e Teatrit Kombëtar. Në radhë të parë, ne jemi shqiptarë dhe, në radhë të dytë, jemi deputetë të zgjedhur nga qytetarët, ndaj e kemi detyrë sublimë të mbrojmë trashëgiminë tonë historike e kulturore dhe të mos e lejojmë identitetin tonë të zhbëhet për hatër të xhepave të askujt. Butrinti, të dashur qytetarë, u përket shqiptarëve dhe të gjithë Shqipërisë. Faleminderit!